



**Informim javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°33/2022

Hagë, 15/09/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Këtë javë, Zyra e Prokurorit të Specializuar, mbrojtësja e viktimave dhe Mbrojtja po bëjnë deklaratat përmbyllëse të tyre në gjykimin e Salih Mustafës.

Të martën, Prokurori i Specializuar i kërkoi Trupit Gjykses të shpallë z. Mustafa fajtor në lidhje me të gjitha krimet e paraqitura në Aktakuzë dhe shqiptojë një dënim të njëjësuar me 35 vjet burgim.

Të mërkurën, mbrojtësja e viktimave bëri deklaratën e saj para Trupit Gjykses në lidhje me ndikimin e krimeve të pretenduara mbi viktimat pjesëmarrëse në këtë proces.

Pas deklaratës së mbrojtëses së viktimave, Mbrojtja bëri deklaratën e vet përmbyllëse. Mbrojtja i kërkoi Trupit Gjykses ta shpallë z. Mustafa të pafajshëm në lidhje me të gjitha krimet e paraqitura në Aktakuzë.

Seancat publike në këtë gjykim vazhduan edhe sot, me vazhdimin e deklaratës përmbyllëse të Mbrojtjes. Pjesë e rendit të ditës të seancës janë edhe përgjigjet, pyetjet e Trupit Gjykses dhe deklaratat e mbrojtëses së viktimave dhe Mbrojtjes në lidhje me zhdëmtimet.

Sa u përket hapave të ardhshëm në këtë proces gjyqësor, në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, pasi Trupi Gjykses ta deklarojë çështjen gjyqësore të mbyllur, gjykatësit fillojnë kuvendimet për të marrë vendimin e gjykimit.

Më 8 shtator, Mbrojtësit e Selimit, Veselit dhe të Thaçit dorëzuan apelet e tyre me shkrim kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi trajtimin e

1





**Informim javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°33/2022

Hagë, 15/09/2022

informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktet me dëshmitarët e palës kundërshtare.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se çështja gjyqësore kundër Pjetër Shalës do të jetë gati për t'iu kaluar një trupi gjykues të mërkurën më 21 shtator. Kryetarja tani do të caktojë trupin gjykues në këtë çështje.

Në prag të aktivitetit të Kryetares së DHSK-së Trendafilova në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim, me përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë në Gjilan javën e ardhshme më 21 shtator, u kujtojmë gazetarëve që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet të regjistronen për pjesëmarrje më së voni deri nesër, e premtë.

### **Pyetje nga gazetarët**

Pas deklaratës, një gazetare pyeti për pjesëmarrjen e Salih Mustafës në procedurë përmes video-lidhjes dhe për zhvillimet më të fundit në procedurën Thaçi dhe të tjerët si dhe nëse çështja, aktualisht në fazën paraprake, do të kalojë së shpejti në gjykim.

Zëdhënësi i DHSK-së u përgjigj se çështja Thaçi dhe të tjerët është ende në fazën e procedurës paraprake dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ende nuk ka caktuar një datë për kalimin e çështjes te Trupi Gjykues. U ra dakord që zëdhënësi të kontaktojë sërish me gazetaren lidhur me pyetjen e dytë.

